



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04 - 0029558/26 dt. 21-05-2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Strategjinë Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë, nenin 36 paragrafi 2 dhe nenin 42 paragrafi 1, të Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, si dhe Kërkesën Elektronike nga Zyra e Kryetarit, dt. 20.05.2026, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Komisionit për Hartimin e Planit Komunal për Ri Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2026-2028)

1. **Formohet** Komisioni për Hartimin e Planit Komunal për Ri Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2026-2028, në këtë përbërje:
 - 1.1. Merite Salihu – kryetare, (Drejtorja për Mirëqenie Sociale);
 - 1.2. Fahri Jashari – anëtar, (Zyra e Punësimit);
 - 1.3. Elhame Zeqiri – anëtare, (Drejtorja për Arsim);
 - 1.4. Sebahate Tahiri – anëtare, (Drejtorja për Planifikim dhe Urbanizëm);
 - 1.5. Fitim Rama – anëtar, (Drejtorja për Administratë të Përgjithshme);
 - 1.6. Albana Fejza – anëtare, (Drejtorja për Shëndetësi);
 - 1.7. Minire Ademi Sungur – anëtare, (Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim);
 - 1.8. Besa Veseli – anëtare, (Drejtorja për Administratë të Përgjithshme).
2. Komisioni i lartcekur obligohet të bëjë Hartimin e Draft – Planit Komunal për Ri Integrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2026-2028.
3. Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft – Planit të lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për Shqyrtim dhe Miratim përmes Kryetarit të Komunës.
4. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e

Përgjithshme Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Strategjinë Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë, Rregulloren (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Mandati i Komisionit të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi do të zgjas deri në përfundimin e detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PEÇI



Shtojcë:

Kërkesa Elektronike nga Zyra e Kryetarit, dt. 20.05.2026;
Kërkesa elektronike nga Ministria e Punëve të Brendshme.

T'i dërgohet:

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit

